

**MARRËVESHJE**

**NDËRMJET**

**KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**DHE**

**QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË**

**PËR**

**BASHKËPUNIM TEKNIK**

**2018**

**PËR PROJEKTIN**

**“MENAXHIMI I MODERNIZUAR I MBETJEVE DHE EKONOMIA RICIKLUESE  
NË RESPEKT TË MJEDISIT (DKTI)”**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë

dhe

Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë –

në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë,

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet Bashkëpunimit Teknik si partnerë,

të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje,

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë,

duke iu referuar Protokollit të Bisedimeve Qeveritare të datës 22 nëntor 2018 -

kanë rënë dakord si vijon:

#### **NENI 1**

(1) Në zbatim të Marrëveshjes gjermano-shqiptare të datës 21 tetor 1988 mbi Bashkëpunimin Teknik do të mbështetet projekti i mëposhtëm:

“Menaxhimi i modernizuar i mbetjeve dhe ekonomia ricikluese në respekt të mjedisit  
(DKTI)”

nëse nga shqyrtimi përkatës rezulton, se ky projekt vlen për t'u mbështetur.

(2) Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë vë në dispozicion për projektin e përmendur në paragrafin 1 me shpenzimet e saj shërbime në personël dhe materiale, si dhe eventualisht kontribute financimi në një vlerë të përgjithshme prej gjithsej 4.500.000,00 Euro (me fjalë: katër milion e pesëqind mijë euro). Ajo ngarkon me zbatimin e projektit të përmendur në paragrafin 1 Shoqërinë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit - GIZ GmbH).

(3) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë garanton një planifikim të vetin buxhetor, ku shpenzimet e ndryshme klasifikohen në zëra më vete, që të sigurojë kështu zbatimin e vazhdueshëm të projektit të përmendur në paragrafin 1, dhe kujdeset, që institucionet e ngarkuara prej tij me zbatimin e projektit të kryejnë shërbimet e nevojshme për projektin e përmendur në paragrafin 1.

(4) Projekti i përmendur në paragrafin 1 mund të zëvendësohet nga projekte të tjera, nëse palët e kësaj marrëveshjeje bien dakord për këtë.

(5) Angazhimet e marra referuar projektit të përmendur në paragrafin 1 dhe shumës së përmendur në paragrafin 2 në kuadër të Bashkëpunimit Teknik do të zhvlerësohen pa kompensim, në rast se brenda katër viteve pas vitit të premtimit financiar nuk janë lidhur ende kontratat përkatëse të zbatimit dhe eventualisht të financimit përmendur në nenin 2. Për këto shuma afati përfundon me mbarimin e datës 31 dhjetor 2022. Nëse kontratat e zbatimit dhe eventualisht të financimit lidhen brenda afatit të parashikuar vetëm për një pjesë të premtimit financiar, atëherë kjo klauzolë zhvlerësimi vlen vetëm për atë pjesë të fondeve, që nuk është ende objekt i këtyre kontratave.

## NENI 2

Hollësitat e projektit të përmendur në nenin 1 paragrafi 1 si dhe ato mbi detyrimet dhe shërbimet, që duhet të kryhen, do të përcaktohen në kontrata të veçanta zbatimi dhe eventualisht financimi, që do të lidhen ndërmjet institucioneve, që janë ngarkuar apo do të ngarkohen me zbatimin e projekteve në kuptimin e nenit 1, paragrafi 2 dhe 3. Kontratat e

zbatimit dhe eventualisht financimit u nënshtrohen dispozitave ligjore, që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

### NENI 3

(1) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i përjashton materialet, automjetet, mallrat dhe pajisjet, si dhe pjesët e këmbimit të lëvruara në kuadër të projektit të përmendur në nenin 1 paragrafi 1 me porosi dhe me shpenzimet e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë nga detyrimet tarifore të importit dhe të eksportit, detyrimet tarifore për licensat, taksat e portit e të magazinimit, dhe nga taksa të tjera publike, sikurse garanton, që materialet të zhdoganohen pa vonesë.

(2) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton organizatën zbatuese të projektit nga të gjitha taksat dhe tatimet direkte, që lindin në Republikën e Shqipërisë nga lidhja dhe zbatimi i kontratave të zbatimit dhe eventualisht financimit të përmendura në nenin 2.

(3) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë rimbursen me kërkesën e organizatës zbatuese gjermane vlerën e TVSh-së apo të taksave të ngjashme indirekte, që janë mbajtur në Republikën e Shqipërisë mbi objektet e siguruara dhe shërbimet e kryera në kuadër të lidhjes dhe zbatimit të kontratave të zbatimit dhe eventualisht financimit të përmendura në nenin 2. Taksat mbi konsumin të mbajtura në këtë kontekst merren përsipër prej Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë pas bërjes së kërkesës përkatëse.

(4) Kjo marrëveshje vlen si për projektin e përmendur në nenin 1 paragrafi 1 ashtu edhe për masa të tjera vijuese nën të njëjtin titull, nëse qeveritë e dy vendeve tona do të duan të mbështesin më tej këtë projekt. Premtimet financiare të Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për masat vijuese të projektit të përmendur në nenin 1 paragrafi 1 bëhen të ditura përmes njoftimesh zyrtare nga ana e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, e cila i referohet tekstualisht kësaj marrëveshjeje.

#### NENI 4

Edhe për këtë marrëveshje janë të vlefshme dispozitat e marrëveshjes gjermano-shqiptare të datës 21 tetor 1988 mbi Bashkëpunimin Teknik të përmendur në nenin 1 paragrafi 1.

#### NENI 5

(1) Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

(2) Kjo marrëveshje lidhet me një afat të pacaktuar. Secila palë kontraktuese mund ta shfuqizojë atë me shkrim në rrugë diplomatike në çdo kohë; shfuqizimi bëhet i efektshëm 30 ditë pasi pala tjetër kontraktuese ka marrë njoftimin përkatës.

(3) Palët kontraktuese mund të bien dakord për ndryshime të kësaj marrëveshjeje.

(4) Mosmarrëveshjet lidhur me interpretimin apo zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhen në mirëkuptim mes palëve përmes bisedash apo negociatash.

Bërë në Tiranë, më \_\_\_\_\_, në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur të dy tekstet fuqi të barabartë.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



PËR QEVERINË E  
REPUBLIKËS FEDERALE TË  
GJERMANISË



**ABKOMMEN**

**ZWISCHEN**

**DEM MINISTERRAT DER REPUBLIK ALBANIEN**

**UND**

**DER REGIERUNG DER BUNDESREPUBLIK DEUTSCHLAND**

**ÜBER**

**TECHNISCHE ZUSAMMENARBEIT**

**2018**

**„MODERNISIERTE, KLIMAFREUNDLICHE ABFALL - UND  
RECYCLINGWIRTSCHAFT (DKTI)“**

Der Ministerrat der Republik Albanien  
und  
die Regierung der Bundesrepublik Deutschland-

im Geiste der bestehenden freundschaftlichen Beziehungen zwischen der Republik Albanien und der Bundesrepublik Deutschland,

in dem Wunsch, diese freundschaftlichen Beziehungen durch partnerschaftliche Technische Zusammenarbeit zu festigen und zu vertiefen,

in dem Bewusstsein, dass die Aufrechterhaltung dieser Beziehungen die Grundlage dieses Abkommens ist,

in der Absicht, zur sozialen und wirtschaftlichen Entwicklung in der Republik Albanien beizutragen,

unter Bezugnahme auf das Protokoll der Regierungsverhandlungen vom 22. November 2018

sind wie folgt übereingekommen:

**ARTIKEL 1**

(1) In Ausführung des deutsch-albanischen Abkommens vom 21. Oktober 1988 über Technische Zusammenarbeit wird das folgende Vorhaben gefördert:

„Modernisierte, klimafreundliche Abfall - und Recyclingwirtschaft (DKTI)“,

wenn nach Prüfung die Förderungswürdigkeit dieses Vorhabens festgestellt worden ist.

(2) Die Regierung der Bundesrepublik Deutschland stellt für das in Absatz 1 genannte Vorhaben auf ihre Kosten Personal- und Sachleistungen sowie gegebenenfalls Finanzierungsbeiträge im Gesamtwert von 4 500 000 Euro (in Worten: vier Millionen fünfhunderttausend Euro) zur Verfügung. Sie beauftragt mit der Durchführung des in Absatz 1 genannten Vorhabens die Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH.

(3) Der Ministerrat der Republik Albanien gewährleistet eine eigene aufgeschlüsselte Haushaltsplanung zur Sicherung einer stetigen Durchführung des in Absatz 1 genannten Vorhabens und stellt sicher, dass die von ihr mit der Durchführung zu beauftragenden Institutionen die für das in Absatz 1 genannte Vorhaben notwendigen Leistungen erbringen.

(4) Das in Absatz 1 genannte Vorhaben kann im Einvernehmen zwischen den Vertragsparteien durch andere Vorhaben ersetzt werden.

(5) Die Zusagen für das in Absatz 1 genannte Vorhaben und den in Absatz 2 genannten Betrag der Technischen Zusammenarbeit entfallen ersatzlos, soweit nicht innerhalb von vier Jahren nach dem Zusagejahr die in Artikel 2 genannten Durchführungs- sowie gegebenenfalls Finanzierungsverträge geschlossen werden. Für diese Beträge endet die Frist mit Ablauf des 31. Dezember 2022. Sollten nur für einen Teil der Zusagen in dem vorgesehenen Zeitraum Durchführungs- sowie gegebenenfalls Finanzierungsverträge geschlossen werden, so gilt diese Verfallsklausel nur für die noch nicht durch diese Verträge gebundenen Teilbeträge.

## ARTIKEL 2

Einzelheiten des in Artikel 1 Absatz 1 genannten Vorhabens und der zu erbringenden Leistungen und Verpflichtungen werden in einzelnen Durchführungs- sowie gegebenenfalls Finanzierungsverträgen festgelegt, die zwischen den nach Artikel 1 Absatz 2 und 3 mit der Durchführung der Vorhaben beauftragten oder noch zu beauftragenden Institutionen geschlossen werden. Die Durchführungs- sowie gegebenenfalls die Finanzierungsverträge unterliegen den in der Bundesrepublik Deutschland geltenden Rechtsvorschriften.

## ARTIKEL 3

(1) Der Ministerrat der Republik Albanien nimmt die im Auftrag und auf Kosten der Regierung der Bundesrepublik Deutschland eingeführten Materialien, Fahrzeuge, Güter und Ausrüstungsgegenstände sowie Ersatzteile, die für das in Artikel 1 Absatz 1 genannte Vorhaben verwendet werden, von sämtlichen Ein- und Ausfuhrabgaben sowie von Lizenzen, Hafen- und Lagergebühren sowie von sonstigen öffentlichen Abgaben aus und stellt die unverzügliche Freigabe sicher.

(2) Der Ministerrat der Republik Albanien befreit die Durchführungsorganisation von sämtlichen direkten Steuern, die im Zusammenhang mit dem Abschluss und der Erfüllung der in Artikel 2 genannten Durchführungs- sowie gegebenenfalls Finanzierungsverträge in der Republik Albanien entstehen.

(3) Der Ministerrat der Republik Albanien erstattet auf Antrag der deutschen Durchführungsorganisation die Umsatzsteuer oder ähnliche indirekte Steuern, die der Republik Albanien auf beschaffte Gegenstände und in Anspruch genommene Dienstleistungen im Zusammenhang mit dem Abschluss und der Erfüllung der in Artikel 2 genannten Durchführungs- sowie gegebenenfalls Finanzierungsverträge in der Republik

Albanien erhoben wurden. In diesem Zusammenhang erhobene Verbrauchsteuern werden auf Antrag vom Ministerrat der Republik Albanien übernommen.

(4) Dieses Abkommen gilt sowohl für das in Artikel 1 Absatz 1 genannte Vorhaben als auch für künftige Folgemaßnahmen mit demselben Titel, sofern unsere beiden Regierungen die Förderung dieses Vorhabens weiterführen wollen. Förderzusagen der Regierung der Bundesrepublik Deutschland für Folgemaßnahmen für das in Artikel 1 Absatz 1 genannte Vorhaben erfolgen durch offizielle Mitteilung der Regierung der Bundesrepublik Deutschland, die auf dieses Abkommen ausdrücklich Bezug nimmt.

#### ARTIKEL 4

Im Übrigen gelten die Bestimmungen des in Artikel 1 Absatz 1 genannten deutsch-albanischen Abkommens vom 21. Oktober 1988 über Technische Zusammenarbeit auch für dieses Abkommen.

#### ARTIKEL 5

(1) Dieses Abkommen tritt an dem Tag in Kraft, an dem der Ministerrat der Republik Albanien der Regierung der Bundesrepublik Deutschland mitgeteilt hat, dass die innerstaatlichen Voraussetzungen für das Inkrafttreten erfüllt sind. Maßgebend ist der Tag des Eingangs der Mitteilung.

(2) Dieses Abkommen wird auf unbestimmte Zeit geschlossen. Jede Vertragspartei kann es jederzeit schriftlich auf diplomatischem Weg kündigen; die Kündigung wird 30 Tage nach Eingang bei der anderen Vertragspartei wirksam.

(3) Die Vertragsparteien können Änderungen dieses Abkommens vereinbaren.

(4) Streitigkeiten über die Auslegung oder Anwendung dieses Abkommens werden durch die Vertragsparteien gütlich im Rahmen von Gesprächen beziehungsweise Verhandlungen beigelegt.

Geschehen zu Tirana am \_\_\_\_\_ in zwei Urschriften, jede in albanischer und deutscher Sprache, wobei jeder Wortlaut gleichermaßen verbindlich ist.

FÜR DEN MINISTERRAT DER  
REPUBLIK ALBANIEN

FÜR DIE REGIERUNG DER  
BUNDESREPUBLIK DEUTSCHLAND

